



PRANIMET ME:

ACCEPTED ON: 22/02/2024

PRILJENI:

Mr.No.Rt. 01/206



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E MALISHEVËS

**VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT
(2024 – 2026)**

Komuna Malishevë:

Numri: 01__

Data: 22.02.2024

Vendi: Malishevë

Në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, më datë: **22.02.2024** Kryetari i Komunës së Malishevës nxjerr:

VENDIM

1. Miratohet plani i integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr.01/1609 datë:08/12/2023
2. **Znj.Z, Albrim Paçarizi, Zyrtar për Integritete Evropiane**,Komuna Malishevë caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022),

në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me date:27.07.2023 Kryetari i Komunës nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim Nr.01/1609 datë:08/12/2023, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

Znj.Z, Albrim Paçarizi, Zyrtar për Integritete Evropiane sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Personit përgjegjës;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

